



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1211/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lumnije Thaçi kandidate për anëtarë të kuvendit komunal nga radhët e PDK-së në Malishevë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lumnije Thaçi, kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Malishevë, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:20 nga kandidatja për anëtarë të kuvendit komunal nga radha e PDK-së Lumnije Thaçi, ku ka pretenduar se janë bërë manipulime nga KQZ-ja ku nuk më figuroj votat e familjareve të mi, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidates për anëtarë të kuvendit komunal nga radha e PDK-së Lumnije Thaçi janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete, pasi qe ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1211/2013 më datën 06.12.2013.



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.